

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting**

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 15.06.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKCAK-</u> PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Kontabilisti i kompanisë Oqeani shpk, ka kërkuar që ju si këshilltar t'i përgatitni disa informata në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme. Kompania ju ka ofruar informatat si në vijim:

(i) Saldo fillestare në llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme ishte si në vijim:

Llogaritë e arkëtueshme:	Debi	€56,247
Llogaritë e pagueshme:	Kredi	€68,164

(ii) Në vijim janë transaksionet të cilat kanë ndodhur për vitin i cili përfundon më 31 dhjetor 2018 në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme:

	€
Shitjet me afat/kredi	345,812
Shitjet me para të gatshme	10,845
Blerjet me afat/kredi	220,541
Kthimet e shitjeve me afat/kredi	6,475
Kthimet e blerjeve me afat/kredi	20,169
Kontra hyrjet	15,467
Zbritjet e lejuara	14,852
Zbritjet e marra	23,253
Shumat e paguara në para të gatshme për llogaritë e pagueshme	194,652
Shumat e arkëtuara në para të gatshme nga llogaritë e arkëtueshme	362,145
Borxhet e këqija	1,571
Lejimet për borxhet e dyshimta	1,854

Kërkohet:

(a) Përgatitni Llogarinë Kontrolluese të të Arkëtueshmeve dhe Llogarinë Kontrolluese të të Pagueshmeve, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018,

(8 pikë)

(b) Përgatini hyrjet në ditar për të gjitha transaksionet nën (ii) si më lartë, duke supozuar se asnjë transaksion nuk është regjistruar deri më tani.

(12 pikë)

(Totali: 20 Pikë)

a) Debi	Llogaria kontrolluese e të pagueshmeve €	Kredi €
	Saldo në fillim	
Kthimet e blerjeve	20,169	68,164
Kontrahyrjet	15,467	220,541
Zbritjet e marra	23,253	
Paraja e gatshme	194,652	
Saldo balancuese	<u>35,164</u>	-
	<u>288,705</u>	288,705
	Saldo përfundimtare	35,164
Debi	Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve €	Kredi €
Saldo në fillim	56,247	€
Shitjet me kredi	345,812	Kthimet e shitjeve
		Kundërhyrjet
		6,475
		Zbritjet e lejuara
		15,467
		Paraja e gatshme
		14,852
		362,145
		Borxhet e këqija
		1,571
		Saldo balancuese
		1,549
Saldo përfundimtare	<u>402,059</u>	<u>402,059</u>
	1,549	

Shënim: Shitjet me para të gatshme nuk përfshihen në LL/A, Lejimet për borxhet e dyshimta janë konto e ndarë e cila paraqitet në B/Gj.

b)			
D.	LL/A	345,812	
K.	Të hyrat nga shitja		345,812
D.	Paraja e gatshme	10,845	
K.	Të hyrat nga shitja		10,845
D.	Blerjet	220,541	
K.	LL/P		220,541
D.	Kthimet e shitjeve	6,475	
K.	LL/A		6,475
D.	LL/P	20,169	
K.	Kthimet e blerjeve		20,169
D.	LL/P	15,467	
K.	LL/A		15,467
D.	Zbritjet e lejuara	14,852	
K.	LL/A		14,852
D.	LL/P	23,253	
K.	Zbritjet e marra		23,253
D.	LL/P	194,652	
K.	Paraja e gatshme		194,652
D.	Paraja e gatshme	362,145	
K.	LL/A		362,145
D.	Shpenzimet e borxheve të këqija	1,571	
K.	LL/A		1,571
D.	Shpenzimet e borxheve të dyshimta	1,854	
K.	Lejimet për borxhet e dyshimta		1,854

Problemi 2

Bilanci vërtetues për z. Mentor Dushi, biznes individual për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018, nuk është barazuar. Z.Mentori ka identifikuar çështjet si në vijim dhe ka kërkuar ndihmë nga ju. Këto çështje janë paraqitur në vijim:

1. Sigurimi për shtëpinë e tij prej €1,000 ishte paguar nga llogaria e biznesit dhe ishte përfshirë në shpenzimet e sigurimit të biznesit.
2. Kthimet e blerjeve prej €600 janë regjistruar në librin e kthimeve të shitjes.
3. Një borxh i keq prej 840 € i cili ishte shlyer vitin e kaluar është arkëtuar (është kthyer) në këtë vit. Kjo gjë është regjistruar si kredi në shpenzimet e borxheve të këqija të këtij viti, ndërsa regjistrimi i saktë është bërë në të gjitha llogaritë tjera.
4. Z.Mentori ka investuar €2,000 në biznes gjatë muajit Dhjetor 2018. Regjistrimi i bërë ishte ky:

Debi	Banka	€2,000	
	Kredi	Të hyrat	€2,000

5. Norma e zhvlerësimit është përdorur gabimisht si 20% me metodën drejtvizore në vend të 10% sa ka qenë saktë. Kosto e pasurive jo-qarkulluese ishte 20,000 €. Për të regjistruar shpenzimet e zhvlerësimit kontabilisti ka debituar KMSH dhe ka kredituar pasuritë jo-qarkulluese me kosto.
6. Të hyrat nga interesi në depozita të arkëtuara në bankë në shumë prej 800 € janë përfshirë në shpenzimet e interesit.
7. Shpenzimet e mirëmbajtjes të paisjeve të papaguara prej €3,000 ishin kapitalizuar si pasuri të patundshme, pajisje dhe impijante të prodhimit. Norma e zhvlerësimit për këto pasuri ishte 10% me metodën drejtvizore.

Para korrigjimit të gabimeve, fitimi bruto i këtij biznesi ishte €65,600 dhe fitimi neto ishte €26,400.

Kërkohet:

- (a) Përgatitni hyrjet në ditar/konto për të korrigjuar gabimet e paraqitura për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018.
(12 pikë)
- (b) Kalkuloni fitimin bruto të korrigjuar dhe fitimin neto të korrigjuar për biznesin.
(8 pikë)

(Totali: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

1. Regjistrimi i saktë

D Tërheqjet e pronarit 1,000
K Paraja e gatshme 1,000

Regjistrimi i gabuar

D Shpenzimet e sigurimit 1,000
K Paraja e gatshme 1,000

Korrigjimi

D Tërheqjet 1,000
K Shpenzimet e sigurimit 1,000

2. Regjistrimi i saktë

D LL/P 600
K Kthimet e blerjeve 600

Regjistrimi i gabuar

D LL/P 600
D Kthimet e shitjeve 600
K Llogaria pezull 1,200

Korrigjimi

D Llogaria pezull 1,200
K Kthimet e shitjeve 600
K Kthimet e blerjeve 600

3. Regjistrimi i saktë

D LL/A 840
K Të hyrat nga borxhet e këqija 840
D Paraja e gatshme 840
K LL/A 840

Regjistrimi i gabuar

D LL/A 840
K Shpenzimet e borxheve të këqija 840

D Paraja e gatshme 840
K LL/A 840

Korrigjimi

D Shpenzimet e borxheve të këqija të këtij viti 840
K Të hyrat nga borxhet e këqija 840

4. Regjistrimi i saktë

D Banka ose Paraja e gatshme	2,000	
K Investimi i pronarit		2,000

Regjistrimi i gabuar

D Banka	2,000	
K Të hyrat		2,000

Korrigjimi

D Të hyrat	2,000	
K Investimi i pronarit		2,000

5. Regjistrimi i saktë

D Shp. zhvlerësimit	2000 (20,000 × 0.10)	
K Zhv i akumuluar		2000

Regjistrimi i gabuar

D KMSH	4000 (20,000 × 0.20)	
K Pas jo qarkulluese-Kosto		4000

Korrigjimi

D Shp e zhvlerësimit	2000	
D Pasuria jo qarkulluese-kosto	4000	
K KMSH		4000
K Zhv. i akumuluar		2000

6. Regjistrimi i saktë

D Paraja e gatshme	800	
K Të hyrat nga interesi		800

Regjistrimi i gabuar

D Paraja e gatshme	800	
D Shpenzimet e interesit	800	
K Llogaria Pezull		1,600

Korrigjimi

D Llogaria pezull	1,600	
K Shpenzimet e interesit		800
K Të hyrat nga interesi		800

7. Regjistrimi i saktë

D Shpenzimet e mirëmbajtjes	3,000	
K Të pagueshmet për mirëmbajtje (Akrualet)		3,000

Regjistrimi i gabuar

D Pasuria jo qarkulluese	3,000	
K Të pagueshmet për mirëmbajtje (Akrualet)		3,000

D Shpenzimet e zhvlerësimit	300	
K Zhvlerësimi i akumuluar		300

Korrigjimi

D Shpenzimet e mirëmbajtjes	3,000	
K Pasuria jo qarkulluese		3,000

D Zhvlerësimi i akumuluar	300	
K Shpenzimet e zhvlerësimit		300

b) Fitimi bruto i pakorrigjuar	65,600
Korrigjimet:	
2.Kthimet e shitjeve	+600
2. Kthimet e blerjeve	+600
4.Të hyrat	-2,000
5. KMSH	+4,000
Fitimi bruto i korrigjuar	68,800

Fitimi neto i pakorrigjuar 26,400

1.Shpenzimet e sigurimit	+1,000
2.Kthimet e shitjeve	+600
2. Kthimet e blerjeve	+600
3.Efekti është zero (+840-840)	0
4.Të hyrat	-2,000
5. KMSH	+4,000
5. Shp e zhvlerësimit	-2,000
6.Të hyrat nga interesi	+800
6. Shpenzimet e interesit	+800
7. Shp. e mirëmbajtjes	-3,000
7.Shp. e zhvlerësimit	+300

Fitimi neto i korrigjuar 27,500

Problemi 3

Franca shpk ka pasqyrat financiare si në vijim:

Pasqyra e pozicionit financiar e Franca shpk më 31 dhjetor 2018

	2018 €'000	2017 €'000
Pasuritë jo qarkulluese		
Pasuritë e patundshme, impijantet dhe pajisjet	<u>2,850</u>	<u>2,050</u>
Totali i pasurive jo qarkulluese	<u>2,850</u>	<u>2,050</u>
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	580	600
Llogaritë e arkëtueshme	420	300
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	<u>30</u>	<u>50</u>
Totali i pasurive qarkulluese	<u>1,030</u>	<u>950</u>
Totali i pasurive	<u>3,880</u>	<u>3,000</u>
Ekuiteti dhe detyrimet		
Kapitali aksionar	1,100	900
Premia në aksione	200	100
Fitimet e mbajtura	980	610
Rezerva e rivlerësimit	<u>300</u>	<u>100</u>
Totali i Ekuitetit	<u>2,580</u>	<u>1,710</u>
Detyrimet afatgjata		
Kredia afatgjatë	<u>950</u>	<u>800</u>
Totali i detyrimeve afatgjata	<u>950</u>	<u>800</u>
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	290	320
Mbitërheqja bankare	20	120
Tatimi i pagueshëm	<u>40</u>	<u>50</u>
Totali i detyrimeve afatshkurta	<u>350</u>	<u>490</u>
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve	<u>3,880</u>	<u>3,000</u>

Pasqyra e të ardhurave e Franca shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

	€'000
Të hyrat nga shitja	11,700
KMSH	<u>(10,400)</u>
Fitimi bruto	1,300
Shpenzimet e shpërndarjes	(520)
Shpenzimet administrative	(250)
Shpenzimet e interesit	<u>(50)</u>
Fitimi para tatimit	480
Shpenzimet e tatimit	<u>(60)</u>
Fitimi neto	420

Shënime:

- ⌘ Pasuria joqarkulluese me vlerë neto në libra prej €280,000 ishte shitur gjatë vitit 2018 për €290,000. Kjo pasuri kishte koston prej €450,000.
- ⌘ Shpenzimet e zhvlerësimit gjatë vitit 2018 ishin €400,000.
- ⌘ Dividentët e paguara gjatë vitit 2018 ishin €50,000.

Kërkoet:

Përgatitni Pasqyrën e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018 për Franca shpk, sipas kërkesave të *SNK7-Pasqyra e rrjedhave të arkës*.

[Totali: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 3

Pasqyra e rrjedhave të arkës për Franca shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

	€'000	€'000
Aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	480	
Korrigjimet:		
Zhvlerësimi	400	
Fitimi kapital	- 10	
Shpenzimet e interesit	<u>50</u>	
	920	
Rritja në LL/A	- 120	
Zvogëlimi në stoqe	20	
Zvogëlimi në LL/P	<u>- 30</u>	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	790	
Interesi i paguar	- 50	
Tatimi i paguar	<u>- 70</u>	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		670
Aktivitetet investuese		
Blerjet e pasurive jo qarkulluese	- 1,280	
Shtjet e pasurive jo-qarkulluese	290	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		- 990
Aktivitetet financuese		
Emetimi i aksioneve (200+100)	300	
Marrja e kredisë afatgjatë	150	
Dividenta e paguar	<u>- 50</u>	
		400
Rrjedha neto e parasë gjatë vitit		80
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fillim	Shënimi 1	<u>- 70</u>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fund	Shënimi 1	<u>10</u>
Shënimi 1	2018	2017
	€'000	€'000
Paraja e gatshme	30	50
Mbitërheqja bankare	<u>- 20</u>	<u>-120</u>
Paraja e gatshme	<u>10</u>	<u>-70</u>

Fitimi kapital	€'000
Kosto	450
- Zhvlerësimi i akumuluar	<u>- 170</u>
VNL në datën e shitjes	280
Shitja	<u>290</u>
Fitimi kapital	<u>- 10</u>

Tatimi i pagueshëm

Paraja e gatshme (shifër balancuese)	70	Saldo në fillim	50
Saldo në fund	<u>40</u>	Shpenzimet e tatimit	<u>60</u>
	110		<u>110</u>

Pasuritë e patundshme, impijantet e prodhimit dhe pajisjet

Saldo në fillim	2,050	Zhvlerësimi	400
Rivlerësimi	200	Shitja(VNL)	280
Blerjet (shifër balancuese)	<u>1,280</u>	Saldo në fund	<u>2,850</u>
	<u>3,530</u>		<u>3,530</u>

Problemi 4

Petriti shpk ka blerë 75% të aksioneve të Suzana shpk më 1 Janar 2018 kur fitimet e mbajtura të Suzana shpk ishin €13,000. Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes ishte €11,000. Përgjatë vitit deri më 31 dhjetor 2018, Suzana shpk i shiti mallra Petritit për €30,000 me një marzhë mbi kosto prej 25%. 50% e këtyre mallrave ishin akoma të pa shitura nga Petriti në fund të vitit. Në të njëjtën datë, Petriti i kishte borxh Suzanës €2,000 për mallrat e blera dhe ky borxh është i përfshirë në llogaritë e pagueshme tregtare të Petritit dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare të Suzanës.

Pasqyrat e pozitës financiare të secilës kompani më 31 dhjetor 2018 janë paraqitur në vijim:

	<i>Petriti</i>		<i>Suzana</i>	
	€	€	€	€
<i>Pasuritë</i>				
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>				
Pasuritë e trupëzuara	60,000			20,000
Investimet në S Co sipas koston	<u>66,000</u>			
		126,000		
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	30,000		25,000	
Stoqet	<u>10,000</u>		<u>5,000</u>	
		<u>40,000</u>		<u>30,000</u>
<i>Totali i pasurisë</i>		<u>166,000</u>		<u>50,000</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>				
<i>Ekuiteti</i>				
Aksione të zakonshme nga €1 secila	90,000		20,000	
Fitimet e mbajtura	<u>55,000</u>		<u>22,000</u>	
		145,000		42,000
<i>Detyrimet afatshkurta</i>				
Llogaritë e pagueshme tregtare		21,000		8,000
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u>166,000</u>		<u>50,000</u>

Kërkohet

Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare të konsoliduar për Petriti shpk. [Totali: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 4

P CO

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE E KONSOLIDUAR MË 31 DHJETOR 20X2

	€	€
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Pasuritë e trupëzuara (60,000 + 20,000)		80,000
Zëri i mirë (L11)		44,000
Pasuritë qarkulluese		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare (30,000 + 25,000 - 2,000)	53,000	
Stoqet (10,000 + 5,000 - 3,000 (L12))	<u>12,000</u>	
		<u>65,000</u>
<i>Totali i pasurisë</i>		<u><u>189,000</u></u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë		
Aksione të zakonshme nga €1 secila	90,000	
Fitimet e mbajtura (L13)	<u>59,500</u>	
		149,500
IJK (L14)		<u>12,500</u>
		162,000
Detyrimet afatshkurta (21,000 + 8,000 - 2,000)		<u>27,000</u>
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u><u>189,000</u></u>
<i>Llogaritjet</i>		
1 <i>Zëri i mirë</i>		
	€	€
Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		66,000
Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje		11,000
Minus vlera e drejtë në blerje e pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve të pranuar:		
Kapitali aksionar	20,000	
Fitimet e mbajtura	13,000	
		33,000
Zëri i mirë		44,000
2 <i>Provizioni për fitimin e porealizuar</i>		
		€
Çmimi i shitjes	125%	30,000
Çmimi i kostos	<u>100%</u>	<u>(24,000)</u>
Fitimi bruto	25%	<u><u>6,000</u></u>
Fitimi i porealizuar (6,000 × 50%)		3,000
Fitimi i porealizuar që i takon grupit (3,000 × 75%)		2,250
Fitimi i porealizuar që i takon IJK-së (3,000 × 25%)		750

3	<i>Fitimet e mbajtura</i>	<i>Petriti</i>	<i>Suzana</i>
		€	€
	Sipas pyetjes	55,000	22,000
	Korrigjimet (fitimi i parealizuar që i takon P-së (L12))	(2,250)	-
	Fitimet e mbajtura para blerjes		(13,000)
			<u>9,000</u>
	Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
	S Co (75% × 9,000)	<u>6,750</u>	
	Fitimet e mbajtura të grupit	<u>59,500</u>	
4	<i>IJK në datën e raportimit</i>		€
	Vlera e drejtë e IJK-së në blerje		11,000
	Plus pjesa IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (25% × 9,000)		2,250
	Minus fitimi i parealizuar që i takon IJK-së (L12)		<u>(750)</u>
	IJK në datën e raportimit		<u>12,500</u>

Problemi 5

Njëra ndër detyrat e zakonshme mujore të Arbenit është përgatitja e harmonizimit (rekonsilimit) bankar. Me 30 Qershor Libri i Arkës paraqiste një gjendje në mbitërheqje prej 2,500 €, përderisa ekstrakti i bankës paraqiste një mbitërheqje në vlerë prej 350€.

Arbeni kontrolloi Librin e Arkës dhe Ekstraktin e bankës dhe ka gjetur diferencat e mëposhtme :

- (a) Kompania ka pranuar një çek në vlerë prej 4,000€ dhe e ka regjistruar në Librin e Arkës. Këto ceqe nuk janë transferuar ende në llogarinë bankare.
- (b) Arbeni ka paguar me çeqe në vlerë prej 5,000€, por ende nuk janë paraqitur në ekstrakt.
- (c) Shpenzimet bankare prej 350 € të cilat janë paraqitur në ekstrakt ende nuk ishin regjistruar në Librin e Arkës.
- (d) Çeku në vlerë prej 500 € i pranuar gjatë muajit nga “Drita shpk”, ishte regjistruar dhe ishte dorëzuar në bankë. Fatkeqësisht ky çek ishte kthyer si i papagueshëm më 30 Qershor që edhe shihej në Ekstrakt .Asnjë regjistrim nuk ishte bërë në Librin e arkës për çekun e kthyer.
- (e) Dividenda e pranuar nga investimet në vlerë 2,000€ është pranuar drejpërdrejt në llogarinë e bankës dhe figuronte në Ekstrakt. Asnjë regjistrim nuk është bërë në Librin e Arkës.

Kërkesa:

- 1)Regjistrimi korrigjimet në Librin e Arkës. (10 pikë)
- 2)Përgatiteni harmonizimin bankar për muajin Qershor. (10 pikë)

(Totali 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

Libri i arkës

Dividenda 2000	Saldo e pakorrigjuar	2500
	Shpenzimet bankare	350
	Çeçu i kthyer	500
	Saldo në fund e korrigjuar	1350

Ekstrakti i bankës

	Saldo e pakorrigjuar	(350)
Plus	Ceçet e paarkëtuara (Depozitat në transit)	4000
Minus	Ceçet e papaguara	(5000)
	Saldo e korrigjuar	<u>(1350)</u>